



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONERI**

Nr. 531/6 Prot.

Tiranë, më 01 . 07. 2026

**V E N D I M**

**Nr. 180, Datë 01 . 07 . 2026**

Mbështetur në nenet 32, 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 71 Regj., datë 10.03.2026, të subjektit ankues, Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, Dega Lezhë<sup>3</sup>, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>4</sup>”, të personave të verbër, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, (DR SHSSH) Lezhë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Nga aktet e depozituara pranë KMD-së, nga subjekti ankues, evidentohen rrethanat e faktit dhe pretendimet, si më poshtë:

Pretendimet e subjektit ankues lidhen me ndërprerjen e rimbursimit të energjisë elektrike për personat e verbër, nga ana e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale Lezhë. Sipas VKM nr. 8, datë 14.01.2015, personat e verbër kanë të drejtë të përfitojnë rimbursimin e energjisë elektrike në vlerën 648 lekë në muaj, që korrespondon me 300 kwh energji elektrike në muaj.

Në muajin qershor 2025, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Lezhë vendosi ndërprerjen e këtij rimbursimi për personat e verbër në Bashkinë Lezhë, me arsyetimin se në familjet e tyre ka persona të punësuar.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>3</sup> Në vijim referuar edhe si Shoqata.

<sup>4</sup> Referuar dokumentacionit respektiv, evidentohet se Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, me statusin e të verbërit.

Subjekti ankues pretendon se ky vendim është në kundërshtim të hapur me parashikimet ligjore, pasi VKM-ja nuk parashikon si kriter përjashtues për personat e verbër, faktin nëse ndonjë prej familjarëve të tij është i punësuar.

Për më tepër, në një përgjigje të marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është konfirmuar se personat e verbër janë përfitues të kësaj skeme, sipas legjislacionit në fuqi. Ndërprerja e rimbursimit të energjisë elektrike përbën zbatim të gabuar të legjislacionit, si dhe ka sjellë trajtim të padrejtë e diskriminim të personave të verbër, përfitues, sipas pretendimit të Shoqatës.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të personave të verbër, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e DR SHSSH Lezhë, si dhe marrjen e masave për të garantuar rikthimin e së drejtës së përfitimit të rimbursimit të energjisë elektrike për personat e verbër.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën me nr. 531/1 prot., datë 11.03.2026, ka kërkuar nga DRSHTSH Lezhë, informacionin dhe dokumentacionin respektiv.

2. Me shkresën me nr. 301 prot., datë 27.03.2026, DR SHSSH Lezhë, lidhur me çështjen në fjalë ka sqaruar ndër të tjera se:

Personat e verbër e kanë marrë rimbursimin e energjisë elektrike në vlerën 648 lekë në muaj, nga viti 2015, deri në qershor 2025 nga njësitë administrative të qarkut Lezhë.

DRSHSSH Lezhë nuk ka prodhuar një shkresë zyrtare për ndalimin që kjo kategori personash të verbër të mos marrë rimbursimin e energjisë elektrike në vlerën 648 lekë në muaj.

Sa i përket pretendimit për përjashtim nga përfitimi, çdo rast është trajtuar në mënyrë individuale në përputhje me kriteret ligjore, pasi vetë DRSHSSH Lezhë ka bërë një audit intensiv dy ditor ku është bërë kontrolli mbi dosjet e personave të verbër, të cilët janë përjashtuar nga ky kompensim. Për Bashkinë Lezhë rezulton që janë përjashtuar nga ky rimbursim 45 persona të verbër, nga ku ka lënë detyrë që personave të verbër të cilëve iu është ndaluar gabimisht shuma 648 lekë, do ju kompensohen nga muaji i ndaluar e në vazhdim, por gjithnjë sipas plotësimit të kriterëve dhe kuadrit ligjor, në muajt në vazhdim do të rikontrollohen edhe një herë nëse detyrat janë zbatuar.

DRSHSSH Lezhë mbetet e gatshme të bashkëpunojë me KMD dhe të vërë në dispozicion çdo informacion shtesë të nevojshëm për shqyrtimin e plotë të kësaj çështjeje. Gjithashtu lutemi që të gjithë personat përfitues nga “statusi i të verbërit” të cilët kanë pretendime lidhur me përfitimin e këtij kompensimi mund të paraqiten pranë zyrave të Kujdesit Social në Bashki dhe Njësitë Administrative përkatëse për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me përfitimet nga VKM sipërcituar.

3. Me shkresën me nr.2447/1 prot., datë 30.03.2026, SHSSH, lidhur me çështjen në fjalë ka sqaruar, ndër të tjera se:

VKM nr. 8, datë 14.01.2015, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 1, datë 02.02.2025, i ndryshuar, nuk parashikojnë ndërprerjen e pagesave për kompensimin e energjisë elektrike në vlerën 648 lekë në muaj, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, për personat e verbër, për faktin se në përbërje të familjes së tyre kanë anëtarë të tjerë të punësuar.

4. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 531/4 prot., datë 15.05.2026, njoftoi dhe ftoi palën ankuese, SHSSH dhe DRSHSSH Lezhë për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

5. Seanca dëgjimore u zhvillua më datë 10.06.2026, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit, me praninë e përfaqësuesve ligjorë të të gjithë palëve në këtë proces administrativ<sup>5</sup>, të cilët në thelb u qëndruan të njëjtave parashtrime si ato të dërguara paraprakisht me shkrim pranë KMD-së.

---

<sup>5</sup> Referuar akteve të seancës dëgjimore: procesverbalit të mbajtur dhe audios së regjistrimit të saj.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodë Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Pala ankuese shprehu dakordësinë të tërhiqet nga ankesa, në rast të zgjidhjes së problematikës së paraqitur. Nga ana e SHSSH dhe DRSHSSH Lezhë, u cilësua se do të vlerësonin kërkesën e Shoqatës dhe do dërgonin një përgjigje shkresore.

6. Me shkresën me nr. 625 prot., datë 12.06.2026, DRSHSSH Lezhë, i drejtohet: DRSHSSH Bashkisë Lezhë, DRSHSSH Mirditë, DRSHSSH Kurbin dhe Njësive Administrative të Qarkut Lezhë (për dijeni KMD-së dhe Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, Dega Lezhë), duke kërkuar që:
  - Të kryhet rivlerësimi i të gjitha rasteve të personave me statusin e të verbërit, për të cilët është ndërprerë ose refuzuar përfitimi i kompensimit të energjisë elektrike, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së vendimmarrjes me legjislacionin në fuqi.
  - Në rastet kur konstatohet se ndërprerja e përfitimit nuk është mbështetur në kriteret dhe procedurat e përcaktuara ligjore, të merren masat për rikthimin e përfitimit dhe kompensimin e periudhave përkatëse, sipas procedurave dhe kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
  - Administratorët shoqërorë dhe strukturat përgjegjëse të njësive administrative të ndjekin me kujdes trajtimin e çdo rasti individual, duke respektuar kriteret specifike të përcaktuara për personat e verbër dhe duke shmangur aplikimin e kriterëve që i përkasin kategorive të tjera përfituese.
  - DRSHSSH pranë Bashkisë Lezhë të ushtrojë monitorimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të procesit, me qëllim garantimin e një zbatimi të drejtë dhe korrekt të kuadrit ligjor në të gjitha njësitë administrative të qarkut.
7. Me e-mailin datë 29.06.2026, subjekti ankues, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, Dega Lezhë, deklaroi se tërhiqet nga ankesa pranë KMD-së, pasi problematika e tyre ka gjetur zgjidhje gjatë shqyrtimit tek Komisioneri.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, si dhe nisur nga fakti se vetë Shoqata është tërhequr nga ankesa, pasi duke qenë se problematika e ngritur prej tyre ka marrë zgjidhje, konsideron të arritur qëllimin e ankesës së paraqitur pranë KMD-së.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se, qëllimi për të cilin është filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është paraqitur ankesa.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 71 regj., datë 10.03.2026, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore<sup>6</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarohet të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 71 regj., datë 10.03.2026, të Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, Dega Lezhë, pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa<sup>7</sup>, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta Tafa (BUNGO)**

---

<sup>6</sup> Për analogji shih vendimet: nr. 178, datë 04.06.2024, nr. 257, datë 11.11.2025 dhe nr. 167, datë 15.06.2026, të KMD-së.